

EKSTREMIZMI ONLINE SFIDAT DHE MUNDËSITË NË BALLKANIN PERËNDIMOR

MILO COMERFORD DHE SIMEON DUKIC

SERIA E BALLKANIT PERËNDIMOR

“Ideologët ekstremistë nuk e kufizojnë ndikimin e tyre vetëm brenda vendit. Përkundrazi, propaganda ekstremiste online në Ballkanin Perëndimor shfrytëzon dhe mbështetet në narrativën dhe demografinë rajonale.”

DISA FAKTE

- Demografia dhe historia unike e Ballkanit Perëndimor bëjnë që ekstremizmi online të paraqesë një sfidë me karakter rajonal, që kapërcen kufijtë shtetërorë dhe kontrollin e qeverive individuale.
- Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të jenë vigjilente ndaj grupeve ekstremiste, forcave polarizuese dhe aktorëve armiqësorë shtetërorë që bashkëpunojnë me platformat digjitale për të përfituar nga shqetësimet dhe problemet që shfaqen në shoqëri, duke propozuar zgjidhje supremaciste dhe të dhunshme për to.
- Kërcënimi nga ekstremizmi online në Ballkanin Perëndimor i kapërcen juridiksionet kufitare, gjë që e bën thelbësor bashkëpunimin transkombëtar dhe mbështetjen e vendeve fqinje.

Konteksti

Ballkani Perëndimor përballet me një sfidë të dyfishtë si pasojë e ekstremizmit online. Platformat online po lehtësojnë shënjestrimin specifik të rajonit nga narrativa të ndryshme ekstremiste ndërkombëtare. Ndërkohë, historia dhe gjeopolitika rajonale po përvetësohen për të justifikuar veprimet dhe narrativat ekstremiste në mbarë botën. Kjo dinamikë u spikat veçanërisht në mars të vitit 2019, kur Brenton Tarrant kreu një sulm terrorist tronditës në objektet myslimane të adhurimit në Christchurch të Zelandës së Re. Ndërsa faqja e Tarrantit në Facebook transmetonte drejtpërdrejt ecurinë e sulmit, në sfond dëgjohej një këngë nacionaliste serbe e kohës së luftërave jugosllave dhe e përvetësuar së fundmi si himn nga e djalhta ndërkombëtare ekstremiste.¹ Edhe në armët e tij kishte referenca ndaj rajonit, shkarravitur me emra figurash historike nga Ballkani që i kishin bërë

¹ Murtaza Hussain, “From El Paso to Sarajevo: How White Nationalists have been Inspired by the Genocide of Muslims in Bosnia,” *The Intercept*, 1 shtator 2019, <https://theintercept.com/2019/09/01/bosnian-genocide-mass-shootings/>.

ballë pushtimit osman dhe inkuadronin veprimet e tij si pjesë e një rezistence paralele kundër “islamizimit”.

Përfshirja e Ballkanit Perëndimor në një nënkulturë globale të ekstremit të djathtë online, të asociuar me radikalizimin e australianit Tarrant, mund të duket e çuditshme. Sidoqoftë, ky fenomen është pjesë e një tendence më të gjerë, e cila vë në dukje sfidën gjithnjë e më të madhe që paraqet përhapja e ideologjive ekstremiste transkombëtare në platformat online, si ato xhihadiste të dhunshme ashtu edhe ato të ekstremit të djathtë. Në Ballkanin Perëndimor, kjo paraqet një sërë rreziqesh specifike.

Ekstremizmi online dhe Ballkani Perëndimor

Demografia dhe historia unike e Ballkanit Perëndimor bëjnë që ekstremizmi online të paraqesë një sfidë që është thellësisht rajonale, duke kapërcyer kufijtë shtetërorë dhe kontrollin e qeverive individuale. Ideologët ekstremistë nuk e kufizojnë ndikimin e tyre vetëm brenda vendit. Përkundrazi, propaganda ekstremiste online në Ballkanin Perëndimor shfrytëzon dhe mbështetet në narrativën dhe demografinë rajonale. Shumë ideologë ekstremistë të Ballkanit Perëndimor, për shembull, kanë ndjekës në të gjitha vendet e rajonit ku flitet gjuha e tyre — klerikët Salafixhihadistë nga Kosova me etni shqiptare kanë ndikim edhe te komunitetet shqipfolëse në Shqipëri dhe në Maqedoninë e Veriut,² ndërsa narrativat supremaciste nacionaliste serbe shënjestrojnë popullatat serbe në mbarë Serbinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën dhe Malin e Zi. Këto narrativa ekstremiste të rajonalizuara nuk mund të shihen si të shkëputura nga konfliktet historike dhe tensionet ndëretnike shumëvjeçare brenda rajonit.

Jashtë rajonit, ndikuesit ekstremistë ndërkombëtarë përdorin faqet e internetit për të shënjestruar audiencat në Ballkanin Perëndimor me një pafundësi faqesh interneti ndërkombëtare që propagandojnë përmbajtje në gjuhë lokale, duke depërtuar gjerësisht në hapësirën online të rajonit. Grupet kroate neofashiste, për shembull, po propagandojnë narrativa ekstremiste që synojnë komunitetet e diasporës brenda Ballkanit Perëndimor, me qëllimin për të rishkruar trashëgiminë e Ustasës në Kroaci nga Lufta e Dytë Botërore.³

Ndërkohë, elemente të vogla të komuniteteve të diasporës në Evropën Perëndimore, Amerikën e Veriut dhe Australi luajnë një rol qendror në ndjekjen dhe përhapjen e ekstremizmit online nëpër Ballkanin Perëndimor.⁴ Në zona të tjera, popullatat e Ballkanit Perëndimor shënjestrohen edhe nga narrativat ekstremiste islamike. IslamHouse, një faqe e mirënjohur me qendër në zonën e Gjirit që transmeton përmbajtje nga një sërë klerikësh ekstremistë islamikë, transmeton mbi nëntë mijë artikuj në gjuhët e Ballkanit Perëndimor (krahasuar me shtatë mijë skedarë në gjuhën angleze). Në vitin 2015, portali i supremacistëve të bardhë me qendër në SHBA, Stormfront, numëronte 180 000 postime në forumin e tij me fokus Evropën Juglindore, kryesisht nga Ballkani Perëndimor. Asokohe, përqindjet më të larta të kërkimeve në Stormfront në nivel global ishin nga Serbia dhe Kroacia, sipas të dhënave nga Google Trends.⁵

2 Vesë Kelmendi dhe Rudinë Jakupi, *Countering the Myths of IS: How to Counter the IS Narrative Online? The Case of Albanian-Speaking Countries*, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2019, http://www.qkss.org/repository/docs/Countering-ISIS-myths-eng_724280.pdf.

3 Gjatë Luftës së Dytë Botërore, një pjesë e Mbretërisë Jugosllave sundohej nga një shtet marionetë e nazistëve, nën udhëheqjen e regjimit Ustata të Kroacisë, i cili ishte përgjegjës për akte barbare në masë kundër hebrenjve, serbëve dhe romëve. Shihni më shumë për grupet e diasporës: Sven Milekic, “Croatia’s Far Right Draws Strength from Diaspora,” *Balkan Insight*, 5 janar 2018, <https://balkaninsight.com/2018/01/05/croatian-far-right-draws-strength-from-diaspora-01-04-2018/>.

4 “Balkan Terror Trials Reveal Links to Western Europe”, Balkans Investigative Research Network, 9 janar 2018 <https://balkaninsight.com/2018/01/09/balkan-terror-trials-reveal-links-to-western-europe-01-08-2018/>.

5 Joseph Bernstein, “The Internet’s United Nations of White Nationalists”, *Buzzfeed News*, 24 qershor 2015, <https://www.buzzfeednews.com/article/josephbernstein/the-internets-united-nations-of-white-nationalists>.

Interneti po nxjerr në skenën botërore narrativat ekstremiste specifike për rajonin. Këto narrativa e kuadrojnë Ballkanin Perëndimor, me diversitetin e tij unik fetar dhe kulturor, si një front të parë të përplasjes së qytetërimeve midis botës së krishterë dhe asaj islame. Në një film propagandistik të arrirë të vitit 2015, ISIS e shpalli Ballkanin Perëndimor “vijën e re kufitare” të xhihadit botëror, si për rajonin ashtu edhe për ndjekësit e tij në mbarë botën. Narrativa që theksohet në video është se myslimanët kanë qenë për një kohë të gjatë nën zgjedhën e shteteve “ateiste” komuniste të Shqipërisë dhe Jugosllavisë, dhe më pas i janë nënshtruar krimeve kundër njerëzimit nga ana e të krishterëve gjatë luftërave në Jugosllavi. Në skajin tjetër të spektrit ekstremist, një i vetëquajtur “urdhër militant i krishterë”, me qendër në Mbretërinë e Bashkuar, deklaroi se po zhvillonte një “luftë online” në rajon, duke pretenduar të arrinte një audiencë online prej dhjetëra milionë ndjekësish me videot e tij në serbisht dhe kroatisht.⁶ Grupi ofronte gjithashtu mbështetje jashtë mjedisit virtual për grupet me bazë në Kosovë, duke siguruar pajisje dhe veshje ushtarake në mbështetje të “frontit të parë në luftën për mbrojtjen e botës së krishterë nga pushtimi islamist.”⁷

Lidhja me Politikën dhe Praktikën

Përpyekjet e aktorëve të huaj dhe të brendshëm shtetërorë dhe joshtetërorë për të nxitur destabilizimin dhe për të manipuluar çështjet përçarëse në rajon kanë potencialin të çojnë në rritje të mosmarrëveshjeve etnike dhe të cënueshmërisë së mundshme ndaj radikalizimit në Ballkanin Perëndimor.⁸ Kjo është veçanërisht e vërtetë në skenarë krizash, siç është pandemia globale COVID—19, të cilën grupe të ndryshme po e shfrytëzojnë për të shkaktuar panik dhe antagonizëm midis komuniteteve të ndryshme lokale.⁹ Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të jenë vigjilente ndaj grupeve ekstremiste, forcave polarizuese dhe aktorëve armiqësorë shtetërorë që bashkëpunojnë me platformat digjitale për të përfituar nga shqetësimet dhe problemet që shfaqen në shoqëri, duke propozuar zgjidhje supremaciste dhe të dhunshme për to. Por ndërkohë, ato duhet të jenë gjithashtu të vetëdijshme se paraqitet edhe sfida e eksportimit dhe instrumentalizimit të narrativave të Ballkanit Perëndimor nga grupe ekstremiste jashtë rajonit.

Aktualisht, analiza jonë e vazhdueshme po tregon se kundërpërgjigjet me anë të heqjes së përmbajtjeve ekstremiste nuk po funksionojnë, pjesërisht për shkak të ndërjegjësimit të kufizuar lidhur me mjedisin e kërcënimeve online, mungesës së bashkëpunimit efektiv midis qeverisë, shoqërisë civile dhe kompanive të teknologjisë, dhe zhvendosjes së aktivitetit të jashtëligjshëm online drejt platformave të mesazheve të enkriptuara. Grupet dhe individët e ndaluar, të ndjekur penalisht nën akuza të terrorizmit, kanë vazhduar të jenë të pranishëm online, me gjithë përpyekjet qeveritare jashtë mjedisit virtual për të frenuar veprimtaritë e tyre. Për shembull, “xhihadistët e mediave sociale” vazhdojnë të përdorin Facebook-un për të ndarë lirisht materiale audio-vizuale dhe citime predikimesh nga imamë radikalë, që aktualisht janë duke vuajtur dënime me burg për rekrutimin e individëve për të shërbyer në radhët e ISIS-it.¹⁰ Ndonëse çështja e parandalimit, zbutjes dhe adresimit të ekstremizmit online është me rëndësi globale, ekzistojnë një sërë faktorësh specifikë për rajonin që lidhen me politikën efektive dhe reagimet e instancave përgjegjëse.

6 Jelena Cosic, Lawrence Marzouk, dhe Ivan Angelovski, “British Nationalist Trains Serb Far-Right for ‘Online War’,” *Balkan Insight*, 1 maj 2018, <http://www.balkaninsight.com/en/article/british-nationalist-trains-serb-far-right-for-online-war--04-30-2018>.

7 Cosic, Marzouk, Angelovski, “British Nationalist.”

8 Sophie Eisentraut dhe Stephanie de Leon, *Propaganda and Disinformation in the Western Balkans: How the EU Can Counter Russia’s Information War* (Berlin: Konrad Adenauer Stiftung, 2018) 3–4, http://www.kas.de/wf/doc/kas_51729-544-2-30.pdf?180306092933.

9 Albana Shehaj, “After the Pandemic: Perils and Promise for Western Balkans,” *Balkan Insight*, 20 prill 2020, <https://balkaninsight.com/2020/04/20/after-the-pandemic-perils-and-promise-for-western-balkans/>.

10 Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, “Balkan ‘Social Media Jihadis’ More Dangerous than Ex-Fighters,” 20 dhjetor 2019, <https://www.rcc.int/p-cve/news/259/balkan-social-media-jihadis-more-dangerous-than-ex-fighters>.

Lufta kundër radikalizimit online është konsideruar si përparësi nga qeveritë e Ballkanit Perëndimor:¹¹

- » Strategjia e Serbisë për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm pohon rëndësinë e kundër-mesazheve në luftën kundër radikalizimit online.
- » Strategjia maqedonase propozon ngritjen e kapaciteteve për komunitetet lokale dhe fetare për të luftuar ekstremizmin online.
- » Strategjia boshnjake thekson rëndësinë e monitorimit të hapësirës online, kundër-narrativave dhe kufizimit të propagandës online.
- » Strategjia kombëtare shqiptare parashtron një qasje dydrejtimëshe për të diskredituar dhe kësisoj zbutur ndikimin e propagandës ekstremiste.
- » Rubrika e strategjisë së Kosovës për radikalizimin online konstaton se ISIS ia ka dalë me sukses të sigurojë hapësira online për diskutimin dhe përgatitjen e mesazheve për realizimin me sukses të rekrutimeve në radhët e tij.
- » Strategjia malazeze propozon krijimin e një Njësie Referimi Online për të koordinuar identifikimin e përmbajtjeve terroriste dhe ekstremiste të dhunshme me partnerët.

Megjithatë, pavarësisht prioritizimit, ka fare pak prova të nismave dhe aktiviteteve konkrete të drejtuara nga qeveria për t'iu kundërvënë narrativave ekstremiste online, qoftë në nivel rajonal, qoftë në kombëtar.

Ndonëse ka pasur një sërë përpjekjesh bazike në formën e kundër-narrativave, kryesisht nga grupet islamike që kërkojnë të hedhin poshtë interpretimet ekstremiste fetare, këto përpjekje jo gjithmonë përfitojnë nga këshillat e ekspertëve vendas ose ndërkombëtarë për komunikimet strategjike ose nga burime dhe mbështetje të mjaftueshme për të zhvilluar një luftë efektive kundër kërcënimit që paraqesin mesazhet e grupeve ekstremiste. Për shembull, një portal për përhapjen e kundër-narrativave, "Fol Tash", i drejtuar nga teologë islamë, po përpiqet t'u kundërvihet narrativave të ekstremistëve islamikë, por ka pasur mundësi të kufizuara për të përfshirë dhe angazhuar audiencat vulnerabël që mund të jenë më të rrezikuara nga propaganda islamike e dhunshme.¹² Duke pasqyruar një mungesë globale më të gjerë, përpjekjet për të luftuar ekstremizmin e djathtë me fokus në Ballkanin Perëndimor kanë qenë edhe më të paktën.¹³ Në

11 Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (Vendimi nr. 930), *Albanian National Strategy: Countering Violent Extremism*, Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë (203/2015), 18 nëntor 2015, përkthim jozyrtar, <https://cve.gov.al/wp-content/uploads/2018/11/strategjia-2018-me-ndryshime.pdf>; Republika e Kosovës, Kryeministria, *Strategy on Prevention of Violent Extremism And Radicalisation Leading to Terrorism 2015-2020*, (Prishtinë: Shtator 2015), https://wb-iisg.com/wp-content/uploads/bp-attachments/6122/STRATEGY-on-PVERLT_parandalim_-_ENG.pdf; Bosnjë dhe Hercegovinë, Këshilli i Ministrave, *Strategy of Bosnia and Herzegovina for Preventing and Combating Terrorism 2015-2020*, (Sarajevë: 2015), https://wb-iisg.com/wp-content/uploads/bp-attachments/6102/STRATEGJIA_ZA_BORBU_PROTIV_TERORIZMA_ENG.pdf; Qeveria e Malit të Zi, Ministria e Drejtësisë, *Countering Violent Extremism Strategy 2016-2018*, (Podgoricë: Dhjetor 2015), <https://wb-iisg.com/wp-content/uploads/bp-attachments/6160/Countering-violent-extremism-strategy-2016-2018.pdf>; Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Komiteti Kombëtar për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Terrorizmit, *National Counterterrorism Strategy of the Republic of Macedonia (2018-2022)*, (Shkup: Shkurt 2018), https://wb-iisg.com/wp-content/uploads/bp-attachments/6135/ct_national_strategy_eng_translation_sbu.pdf; Qeveria e Republikës së Serbisë, *National Strategy for the Prevention and Countering of Terrorism for 2017-2021*, <https://wb-iisg.com/wp-content/uploads/bp-attachments/6200/Serbian-National-Strategy-for-the-prevention-and-countermeasures-of-terrorism-for-2017-2021.docx.pdf>.

12 Kelmendi dhe Jakupi, *Countering the Myths of IS*.

13 Jacob Davey, Henry Tuck dhe Amarnath Amarasingam, *An Imprecise Science: Assessing Interventions for the Prevention, Disengagement and De-radicalisation of Left and Right-wing Extremists* (Londër: ISD Global, nëntor 2019), <https://www.>

përgjithësi, në mediat sociale dhe më gjerë në internet, përpjekjet kundër ekstremizmit online nuk kanë arritur të marrin hov dhe të kontestojnë në mënyrë efektive përmbajtjet ekstremiste në hapësirën online.

Duke i pranuar këto mungesa dhe boshllëqe në reagimet në nivel rajonal dhe global, kjo Notë Politike ofron rekomandime për politikëbërësit dhe ekspertët e fushës që synojnë të trajtojnë dhe luftojnë aktivitetet dhe narrativat ekstremiste me fokus Ballkanin Perëndimor në hapësirën online përpara se të shkaktojnë dëme të mëtejshme.

Rekomandime për politika

Të kuptojmë më mirë tablonë dinamike të kërcënimit.

Ekziston një nevojë imediate për një tablo të përditësuar të kërcënimit në rritje, për të siguruar informacion për reagimet strategjike dhe efektive nga ana e qeverisë, ekspertëve të fushës, shoqërisë civile dhe sektorit privat, në mënyrë që të luftohen në mënyrë efektive ideologjitë ekstremiste të dhunshme, si në mjedisin virtual ashtu edhe jashtë tij. Kësisoj, ndërtimi i një infrastrukture të konsoliduar të të dhënave dhe reagimit është thelbësor. Një bazë e përmirësuar të dhënash do t'i lejojë qeveritë të kuptojnë më mirë rreziqet online që lidhen me narrativat ekstremiste, keqinformimin dhe gjuhën e urrejtjes dhe të identifikojnë rrjetet kryesore të shpërndarjes së tyre, duke siguruar njëherazi që të respektohen të drejtat e njeriut dhe privatësia. Është veçanërisht e rëndësishme që të gjitha përpjekjet e shoqërisë të jenë transparente që në konceptim, për t'u mbrojtur nga çdo manipulim i mundshëm për qëllime politike.

Hartuesit e politikave duhet gjithashtu të njohin dhe të përshtaten me këtë tablo të ndryshueshme dhe me dinamikën organizative në rritje të ekstremizmit të dhunshëm. Në veçanti, qeveritë duhet të zhvillojnë kuadro politike dhe ligjore që adresojnë në mënyrë të përshtatshme natyrën gjithnjë e më të decentralizuar, post-organizative dhe "me burime të shumta" të terrorizmit ekstremist të djathtë dhe të sigurohen që ato të mos fokusohen më shumë seç duhet te grupet e ndaluara terroriste, të cilat nuk e japin idenë e larmisë së kërcënimeve që kanosen nga ekstremizmi modern i dhunshëm online. Paralelisht, qeveritë duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha për t'iu përgjigjur edhe përmbajtjeve të ligjshme, ndonëse të dëmshme, të tilla si gjuha e urrejtjes online, duke marrë parasysh zbatueshmërinë e një qasjeje të "detyrimit për kujdes" të bazuar te rreziku për të nxitur rregullimin e platformave. Kjo qasje duhet të përqendrohet në ruajtjen e sigurisë së përdoruesit dhe në mbështetjen e reagimeve të shoqërisë civile me burime më të mëdha dhe kapacitete të përmirësuar, në mënyrë që t'u japë zë këtyre aktorëve të besueshëm për të mbushur këtë boshllëk thelbësor.¹⁴

Të investojmë në ekspertizën rajonale për të adresuar terrin gjuhësor.

Përmbajtjet xhihadiste dhe ato të ekstremit të djathtë në gjuhët e Ballkanit Perëndimor janë të shumta në hapësirat online, me përmbajtje në gjuhën shqipe, serbe dhe boshnjake të aksesueshme lehtësisht në platformat e mediave sociale të të dy grupeve dhe përmes motorëve të kërkimit.¹⁵ Ndërkohë që firmat globale të teknologjisë pretendojnë t'u ofrojnë një përvojë të njëtrajtshme

isdglobal.org/wp-content/uploads/2019/11/An-imprecise-science.pdf.

14 Një shembull i këtij lloji programimi është Nisma e ISD-së për Inkurajimin Qytetar në Internet, e cila vepron në mbarë Evropën për të përmirësuar dhe përshkallëzuar reagimin qytetar ndaj urrejtjes dhe ekstremizmit. Shihni: <https://www.isdglobal.org/programmes/communications-technology/online-civil-courage-initiative-2-2/>.

15 Kërkimet e fundit mbi ekstremizmin online në rajonin e Ballkanit Perëndimor janë kryer nga një sërë ekspertësh, përfshirë Adrian Shtunin, Institutin Tony Blair për Ndryshim Global, Moonshot CVE, Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë dhe Rrjetin e Kërkimeve Hulumtuuese në Ballkan.

dhe të standardizuar përdoruesve në mbarë botën, rregullimi efektiv i platformave kërkon njohuri të lokalizuara gjuhësore dhe kulturore. Kësisoj, në zbatimin e reagimeve të shkallëzuara ndaj ekstremizmit online, firmat globale të teknologjisë duhet të investojnë në konsolidimin e ekspertizës në fushën e shkencave humane, për t'i kuptuar saktë kërcënimet dhe sfidat ekzistuese në Ballkanin Perëndimor dhe për të fuqizuar aftësitë e zbatimit të politikave dhe mundësitë për përmirësim. Megjithatë shumica e kompanive të mediave sociale nuk kanë përfaqësues në Ballkanin Perëndimor, është thelbësore të hulumtohen metoda për forcimin e bashkëpunimit me qeveritë për të krijuar strategji të përbashkëta në luftën kundër mesazheve ekstremiste. Një proces transparent midis qeverive dhe kompanive të teknologjisë, në konsultim me ekspertët dhe shoqërinë civile, duhet të përcaktojë se cilat sfida online plotësojnë kushtet e nevojshme për ndërhyrje ligjore dhe rregullatore, duke respektuar plotësisht të drejtat e njeriut.

Të shkojmë përtej moderimit të përmbajtjeve.

Konsideratat lidhur me rregullimin e platformave të teknologjisë duhet të shkojnë përtej moderimit të thjeshtë të përmbajtjeve, për të adresuar edhe amplifikimin algoritmik të mesazheve terroriste dhe të ekosistemit më të gjerë të ekstremizmit online, duke përfshirë edhe mënyrën sesi algoritmet e kërkimit dhe rekomandimeve mund të jenë duke i shtyrë njerëzit drejt përmbajtjeve ekstremiste online. Ndonëse janë bërë hapa të vegjël për t'i shtrirë përpjekjet përtej heqjes së përmbajtjeve, ende nuk janë vënë në zbatim përpjekje sistematike. Publikimet e fundit nga Facebook-u nuk ngjallën reagimin e duhur nga kompania ndaj sfidave më të thella algoritmike lidhur me ekstremizmin online, pavarësisht faktit se hulumtimet e brendshme të kryera në vitin 2016 treguan se “64% e të gjitha anëtarësimeve në grupe ekstremiste janë pasojë e mjeteve të rekomandimit të [platformës].”¹⁶

Të zhvillojmë një reagim rajonal ndaj një sfide rajonale.

Kërcënimi nga ekstremizmi online në Ballkanin Perëndimor i kapërcen juridiksionet kufitare, gjë që e bën thelbësor bashkëpunimin transkombëtar dhe mbështetjen e vendeve fqinje. Kjo është veçanërisht e rëndësishme me komunitetet gjuhësore që kapërcejnë kufijtë shtetërorë. Kjo sfida afirmohet në Planin e Përbashkët të Veprimit për Luftën kundër Terrorizmit në Ballkanin Perëndimor, përmes të cilit qeveritë e rajonit kanë marrë përsipër të adresojnë përmbajtjet terroriste online duke ua referuar ato kompanive të internetit dhe duke fuqizuar partnerët e shoqërisë civile që të zhvillojnë narrativa alternative efektive.¹⁷

Megjithatë, ka pak të dhëna për mekanizma konkretë bashkëpunimi. Niveli i përpjekjeve për gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta për këtë problem varion gjerësisht nga njëri vend i Ballkanit Perëndimor në tjetrin. Krijimi i një task force rajonale që grupon departamentet përkatëse qeveritare, ku përfshihen agjencitë ligjzbatuese dhe ato të komunikimeve elektronike, për të identifikuar kërcënimet rajonale, për të shkëmbyer përvoja dhe për të zhvilluar reagime të koordinuara, do t'u jepte shtysë përpjekjeve për të luftuar shfrytëzimin e internetit nga aktorët ekstremistë dhe terroristë. Kjo mund të arrihet gjatë takimeve gjashtëmujore të organizuara nga BE-ja për koordinatorët kombëtarë të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe luftës kundër tij, me synim nxitjen e një bashkëpunimi të tillë. Grupimi i politikëbërësve dhe ekspertëve ndërsektorialë për të ndarë njohuri dhe për të kuptuar më mirë ndikimin e mundshëm të reagimeve ndaj rreziqeve online — duke përfshirë rregullimin digjital, edukimin e qytetarisë digjitale dhe

16 Jeff Horwitz dhe Deepa Seetharaman, “Facebook Executives Shut Down Efforts to Make the Site Less Divisive,” *Wall Street Journal*, 26 maj 2020, <https://www.wsj.com/articles/facebook-knows-it-encourages-division-top-executives-nixed-solutions-11590507499>.

17 “Joint Action Plan on Counter-Terrorism for the Western Balkans,” *Komisioni Evropian*, 5 tetor 2018, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/news/docs/20181005_joint-action-plan-counter-terrorism-western-balkans.pdf.

ndërhyrjet në komunikim — do të ndihmojnë në minimizimin dhe shmangien e efekteve të dëmshme të keqinformimit online, gjuhës së urrejtjes dhe ekstremizmit.¹⁸

Të krijojmë partneritet më të gjerë me shoqërinë civile dhe komunitetet lokale.

Një raport i fundit i "British Council" mbi ekstremizmin në Ballkanin Perëndimor konstaton se individët e anketuar besojnë se kundër-narrativat duhet të përfshihen në programimin e strategjive parandaluese në rajon.¹⁹ Megjithatë, shtetet e Ballkanit Perëndimor vuajnë nga nivele relativisht të ulëta të besimit të publikut te qeveria kombëtare, ndaj efektiviteti i çdo plani të qeverisë për komunikim strategjik pa përfshirjen dhe mbështetjen e shoqërisë civile do të jetë i kufizuar.²⁰ Përpjekjet në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm duhet të aplikojnë një qasje me përfshirjen e të gjithë shoqërisë, për të siguruar përfshirjen e komunitetit dhe fuqizimin e përpjekjeve të shoqërisë civile për të trajtuar ekstremizmin e dhunshëm, çka mund të sigurojë burime unike, rezonancë dhe besueshmëri në nisma të tilla. Për më tepër, qytetet dhe komunitetet lokale duhet të angazhohen në këtë përpjekje, pasi ekstremizmi manifestohet në forma të ndryshme në lokalitete të ndryshme dhe autoritetet dhe organizatat vendore mund të ofrojnë reagime të personalizuar bazuar në këtë kontekst unik.²¹

Ekzistojnë disa shembuj orientues në nivel lokal se si mund të duket në praktikë një qasje me përfshirjen e të gjithë shoqërisë. Rrjeti i Qyteteve të Forta (Strong Cities Network - SNA) ka mbështetur krijimin dhe vënien në funksionim të një modeli të "Rrjetit Lokal të Parandalimit" për të nxitur qasjet e drejtuara nga bashkitë dhe të mbështetura nga shoqëria civile në Kumanovë të Maqedonisë së Veriut. Në këtë kontekst, një entitet shumëpalësh i quajtur "Ekipi i Veprimit në Komunitet" (Community Action Team) është autorizuar që të zhvillojë, koordinojë dhe zbatojë strategji vendore në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, si dhe të planifikojë dhe zbatojë aktivitete së bashku me organizata qeveritare dhe joqeveritare, të përshtatura sipas përparësive të nivelit vendor.²² Qendra për Dialog të Përbashkët (Centre for Common Ground) ka ofruar gjithashtu mbështetje për zhvillimin e Ekipeve të Veprimit në Komunitet në bashkitë Čair (Shkup), Gostivar, dhe Kičevo në Maqedoninë e Veriut, duke u bazuar në modelin lokal të parandalimit.²³

Të nxisim aftësitë e qytetarisë digjitale nëpërmjet edukatës qytetare.

18 Laboratori i Politikave Digjitale të ISD-së dhe Rrjeti i Planifikuesve të Politikave kërkojnë të ndërtojnë një "komunitetet ndërkombëtar të praktikës" me përfshirjen e politikëbërësve dhe ekspertëve të teknologjisë lidhur me çështjet e politikave digjitale. Shihni: <https://www.isdglobal.org/programmes/policy-government-advisory/policy-planners-network/>.

19 Vlado Azinović, *Regional Report: Understanding Violent Extremism in the Western Balkans* (British Council: 2018), https://www.britishcouncil.me/sites/default/files/erf_report_western_balkans_2018.pdf.

20 "Serbia the only WB country with more trust in the government than in the EU," European Western Balkans, 6 gusht 2019 <https://europeanwesternbalkans.com/2019/08/06/serbia-the-only-wb-country-with-more-trust-in-the-government-than-in-the-eu/>.

21 Rrjeti i Qyteteve të Forta, një rrjet global i kryetarëve të bashkive, nëpunësve bashkiakë dhe profesionistëve, dedikuar shkëmbimit të praktikave më të mira për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe polarizimit, ka një anëtarësi prej 44 bashkish në mbarë rajonin, të përkushtuar ndaj krijimit të lokaliteteve të qëndrueshme. Ai mund të lehtësojë forcimin e partneriteteve dhe zhvillimin e komunikimit strategjik për qytetet. Për më tepër, nëpërmjet programit të tij "Qytete të reja" (Young Cities), rrjeti ka mbështetur grupet e të rinjve për të zhvilluar nisma komunitare të drejtuara nga të rinjtë, disa prej tyre në formën e fushatave kundër-narrative.

22 Besim Dogani dhe Nayla Joy-Zein, "SCN's Local Prevention Network Model Expands to the Western Balkans," *Rrjeti i Qyteteve të Forta*, 9 tetor 2019, <https://strongcitiesnetwork.org/en/lpn-model-expands-to-the-western-balkans/>.

23 Për më shumë në lidhje me Qendrën për Dialog të Përbashkët, shihni faqen e tyre: <https://ccg.org.mk/>.

Indeksi i Edukimit Mediatik, i ideuar nga Instituti për Shoqëri të Hapur, sugjeron se Ballkani Perëndimor është ndër rajonet më vulnerabël në Evropë ndaj rreziqeve të mundshme të internetit.²⁴ Të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor²⁵ u pozicionuan në dy pesëshet e fundit për edukimin mediatik dhe rezistencën ndaj keqinformimit, ku Maqedonia e Veriut rezultoi me pikët më të ulëta në Evropë.²⁶ Kërkimet sugjerojnë se aftësitë e edukimit digjital janë thelbësore për të krijuar qëndresë ndaj ekstremizmit, polarizimit dhe radikalizimit.²⁷ Edukimi i një qytetarie efektive digjitale do të jetë thelbësor në pajisjen e të rinjve me njohuritë, mjetet dhe besimin e nevojshëm për të trajtuar sfida të ndërlydhura brenda dhe jashtë mjedisit virtual — përfshirë sfidat që paraqesin lajmet e rreme, keqinformimi dhe teoritë konspirative mes të gjitha moshave.²⁸

Nëpërmjet hartimit aktiv të kurrikulave, programeve të trajnimit të mësuesve dhe burimeve të të nxëniet që japin njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të zhvilluar të menduarit kritik dhe për të nxitur qëndrime mendjehapura, angazhim qytetar dhe bashkëjetesë ndërkulturore, qeveritë mund të krijojnë një qëndresë më të madhe ndaj narrativës ekstremiste dhe rreziqeve të tjera në internet. Ndërsa Agjenda Digjitale e BE-së për vitin 2019 për Ballkanin Perëndimor përqendrohet në promovimin e njohurive digjitale në rajon, është e rëndësishme që nismat të përfshijnë nocione të qytetarisë pozitive në sferën digjitale dhe të nxisin rezistencë ndaj një sërë rreziqesh në internet.²⁹ Këto aktivitete nuk duhet të kufizohen vetëm në arsimin zyrtar, por duhet të përfshijnë edhe arsimin jozyrtar dhe fushatat e ndërgjegjësimit për të garantuar që jo vetëm të rinjtë, por edhe brezat më të mëdhenj në moshë, të cilët preken njësoj nga rreziqet në internet, të ndërgjegjësohen më shumë dhe të kuptojnë më mirë keqinformimin dhe narrativat ekstremiste në hapësirën online.

Përfundimi

Ballkani Perëndimor përballet me një sërë sfidash dhe faktorësh specifikë për rajonin lidhur me ekstremizmin online, që burojnë nga historia e tij unike, demografia e larmishme dhe pozicionimi gjeopolitik, të cilat kanë implikime të rëndësishme për politikëbërjen koherente. Megjithatë, brenda këtij konteksti më të gjerë rajonal, tablotë me divergjencë të konsiderueshme të politikës kombëtare dhe vendore si dhe kërcënimet e ndryshme, kërkojnë reagime të personalizuar në nivel vendor. Kjo Notë Politike parashton një sërë nismash politike konkrete me rëndësi të veçantë për Ballkanin Perëndimor, që variojnë nga përpjekjet e nivelit të lartë për të krijuar qëndresë ndaj ekstremizmit online, deri te përpjekjet e nivelit të ulët për të kontrolluar përmbajtjet e dëmshme në mjedisin online. Këto reagime e vënë theksin tek hapësirat e mundshme për bashkëpunim rajonal dhe përpjekje të integruara, duke pranuar se sfida që paraqet ekstremizmi online për Ballkanin Perëndimor është në vetvete transkombëtare dhe do të arrihet të trajtohet sistematikisht vetëm përmes një ndërthurjeje të reagimeve në nivel kombëtar dhe nismave rajonale të koordinuara.

24 Marin Lessenski, "Just Think about It: Findings of the Media Literacy Index 2019," *Open Society Institute*, Policy Brief 55, 2019, https://osis.bg/wp-content/uploads/2019/11/MediaLiteracyIndex2019_-ENG.pdf.

25 Kosova nuk është përfshirë në studim për shkak të të dhënave të pamjaftueshme.

26 Lessenski, "Just Think about It."

27 Louis Reynolds dhe Ralph Scott, *Digital Citizens: Countering Extremism Online* (Londër: Demos, 2016), <https://www.demos.co.uk/wp-content/uploads/2016/12/Digital-Citizenship-web-1.pdf>.

28 Po aty

29 "Be Internet Citizens" është një shembull i një kurrikule ndërkombëtare që synon ngulitjen e këtyre aftësive. Shihni: <https://internetcitizens.withyoutube.com/>.

Sugjerime për lexim të mëtejshëm

Për sfidat e ekstremizmit rajonal

Azinović, Vlado. *Regional Report: Understanding Violent Extremism in the Western Balkans*. British Council Extremism Research Forum, 2018. https://www.britishcouncil.me/sites/default/files/erf_report_western_balkans_2018.pdf

Beslin, Jelena, dhe Marija Ignjatijevic. *Balkan foreign fighters: from Syria to Ukraine*. Bruksel: Instituti i Bashkimit Evropian për Studimet e Sigurisë, 2017. <https://www.iss.europa.eu/sites/default/files/EUISSFiles/Brief%20%20Balkan%20foreign%20fighters.pdf>.

Morina, Engjellushe, Beatrix Austin, Tim Jan Roetman, dhe Véronique Dudouet. *Community Perspectives on Preventing Violent Extremism: Lessons learned from the Western Balkans*. Berlin: Fondacioni Berghof, 2019. https://www.berghof-foundation.org/fileadmin/redaktion/Publications/Other_Resources/WB_PVE/CTR_PVE_WesternBalkans_Research_Report.pdf

Stronski, Paul, dhe Annie Himes. *Russia's Game in the Balkans*. Nju Jork: Carnegie Endowment për Paqen Ndërkombëtare, 2019. https://carnegieendowment.org/files/Stronski_Himes_Balkans_formatted.pdf

Profile të nivelit kombëtar

Bosnja dhe Hercegovina: Understanding Perceptions of Violent Extremism and Foreign Influence. Uashington, DC: International Republican Institute, 2018. <https://www.iri.org/resource/new-bosnia-and-herzegovina-poll-citizens-pessimistic-about-future-vulnerable-outside>

Bosnia's Dangerous Tango: Islam and Nationalism. Sarajevë / Bruksel: International Crisis Group, 2013. <https://www.crisisgroup.org/europe-central-asia/balkans/bosnia-and-herzegovina/bosnia-s-dangerous-tango-islam-and-nationalism>

Kosovo Wide Assessment of Perceptions of Radicalisation at the Community Level. Prishtinë: Republika e Kosovës, 2017. http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/PVE/UNDP_KS-Wide%20Assessment_eng_web.pdf.

Milanović, Boris. "Mapping Extremist Discourse among Serbian 4Chan /pol/ Users." Në botimin *Extremism and Violent Extremism in Serbia, 21st Century Manifestations of an Historical Challenge*, redaktuar nga Valery Perry, prill 2019.

Qehaja, Florian, dhe Skender Perteshi. *The Unexplored Nexus: Issues of Radicalisation and Violent Extremism in Macedonia*, Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2018. http://www.qkss.org/repository/docs/Extremism_in_macedonia_402663.pdf.

Shtuni, Adrian. *Dynamics of Radicalization and Violent Extremism in Kosovo*. Uashington D.C.: Instituti i Paqes i Shteteve të Bashkuara, Raporti i Posaçëm 397, 2016. <https://www.usip.org/sites/default/files/SR397-Dynamics-of-Radicalization-and-Violent-Extremism-in-Kosovo.pdf>

Për nismat politike ekzistuese në nivel rajonal

Komisioni Evropian. "European Commission launches Digital Agenda for the Western Balkans." Deklaratë për shtyp, 25 qershor 2018. http://europa.eu/rapid/press-release_IP-18-4242_en.htm.

OSBE. *The Role of Civil Society in Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism: A Guidebook for South-Eastern Europe*. Vjenë: Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE), 2018. https://www.osce.org/files/f/documents/2/2/400241_1.pdf.

Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal. "Initiatives to Prevent/Counter Violent Extremism in South East Europe." e martë, 9 gusht 2016. <https://www.rcc.int/pubs/38/annual-report-of-the-secretary-general-of-the-regional-cooperation-council-2017-2018>.

Burimet

Azinović, Vlado. *Regional Report: Understanding Violent Extremism in the Western Balkans*. British Council, 2018. https://www.britishcouncil.me/sites/default/files/erf_report_western_balkans_2018.pdf.

"Balkan Terror Trials Reveal Links to Western Europe." *Balkans Investigative Research Network*, 9 janar 2018, <https://balkaninsight.com/2018/01/09/balkan-terror-trials-reveal-links-to-western-europe-01-08-2018/>.

Be Internet Citizens. <https://internetcitizens.withyoutube.com/>.

Bernstein, Joseph. "The Internet's United Nations Of White Nationalists." *Buzzfeed News*, 24 qershor 2015, <https://www.buzzfeednews.com/article/josephbernstein/the-internets-united-nations-of-white-nationalists>.

Bosnja dhe Hercegovina, Këshilli i Ministrave. *Strategy of Bosnia and Herzegovina for Preventing and Combating Terrorism 2015-2020*. Sarajevë: 2015. https://wb-iisg.com/wp-content/uploads/bp-attachments/6102/STRATEGIJA_ZA_BORBU_PROTIV_TERORIZMA_ENG.pdf.

Centre for Common Ground. <https://ccg.org.mk/>.

Cosic, Jelena, Lawrence Marzouk, dhe Ivan Angelovski. "British Nationalist Trains Serb Far-Right for 'Online War,'" *Balkan Insight*, 1 maj 2018. <http://www.balkaninsight.com/en/article/british-nationalist-trains-serb-far-right-for-online-war-04-30-2018>.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (Vendimi nr. 930). *Strategjia Kombëtare e Shqipërisë: Lufta Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm*. Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë (203/2015), 18 nëntor 2015, përkthim jozyrtar. <https://cve.gov.al/wp-content/uploads/2018/11/strategjia-2018-me-ndryshime.pdf>.

Davey, Jacob, Henry Tuck, dhe Amarnath Amarasingam. "An imprecise science: Assessing interventions for the prevention, disengagement and de-radicalisation of left and right-wing extremists." *ISD Global*, nëntor 2019. <https://www.isdglobal.org/wp-content/uploads/2019/11/An-imprecise-science.pdf>.

Dogani, Besim, dhe Nayla Joy-Zein. "SCN's Local Prevention Network Model Expands to the Western Balkans." *Strong Cities Network*, 9 tetor 2019. <https://strongcitiesnetwork.org/en/lpn-model-expands-to-the-western-balkans/>.

Eisentraut, Sophie, dhe Stephanie de Leon. *Propaganda and Disinformation in the Western Balkans: How the EU Can Counter Russia's Information War*. Berlin: Konrad Adenauer Stiftung, 2018. http://www.kas.de/wf/doc/kas_51729-544-2-30.pdf?180306092933.

Qeveria e Malit të Zi, Ministria e Drejtësisë. *Countering Violent Extremism Strategy 2016-2018*. Podgoricë: dhjetor 2015. <https://wb-iisg.com/wp-content/uploads/bp-attachments/6160/Countering-violent-extremism-strategy-2016-2018.pdf>.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Komiteti Kombëtar për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Terrorizmit. *National Counterterrorism Strategy of the Republic of Macedonia (2018-2022)*. Shkup: shkurt 2018. https://wb-iisg.com/wp-content/uploads/bp-attachments/6135/ct_national_strategy_eng_translation_sbu.pdf.

- Qeveria e Republikës së Serbisë. *National Strategy for the Prevention and Countering of Terrorism for 2017–2021*. <https://wb-iisg.com/wp-content/uploads/bp-attachments/6200/Serbian-National-Strategy-for-the-prevention-and-counter-terror-ism-for-2017-2021.docx.pdf>.
- Horwitz, Jeff, dhe Deepa Seetharaman. "Facebook Executives Shut Down Efforts to Make the Site Less Divisive." *Wall Street Journal*, 26 maj 2020. <https://www.wsj.com/articles/facebook-knows-it-encourages-division-top-executives-nixed-solutions-11590507499>.
- Hussain, Murtaza. "From El Paso to Sarajevo: How White Nationalists have been Inspired by the Genocide of Muslims in Bosnia." *The Intercept*, 1 shtator 2019. <https://theintercept.com/2019/09/01/bosnian-genocide-mass-shootings/>.
- Institute for Strategic Dialogue (ISD). Digital Policy Lab and Policy Planners Network. <https://www.isdglobal.org/programmes/policy-government-advisory/policy-planners-network/>.
- — —. Online Civil Courage Initiative. <https://www.isdglobal.org/programmes/communications-technology/online-civil-courage-initiative-2-2/>.
- "Joint Action Plan on Counter-Terrorism for the Western Balkans." Komisioni Evropian, 5 tetor 2018. https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/news/docs/20181005_joint-action-plan-counter-terrorism-western-balkans.pdf.
- Kelmendi, Vesë, dhe Rudinë Jakupi. *Countering the Myths of IS: How to Counter the IS Narrative Online? The Case of Albanian-Speaking Countries*. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2019. http://www.qkss.org/repository/docs/Countering-ISIS-myths-eng_724280.pdf.
- Marin Lessenski, "Just think about it: Findings of the Media Literacy Index 2019," *Open Society Institute*, Policy Brief 55, 2019, https://osis.bg/wp-content/uploads/2019/11/MediaLiteracyIndex2019_-ENG.pdf.
- Milekic, Sven. "Croatia's Far Right Draws Strength from Diaspora." *Balkan Insight*, 5 janar 2018. <https://balkaninsight.com/2018/01/05/croatian-far-right-draws-strength-from-diaspora-01-04-2018/>.
- Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal. "Balkan 'Social Media Jihadis' More Dangerous than Ex-Fighters." 20 dhjetor 2019. <https://www.rcc.int/p-cve/news/259/balkan-social-media-jihadis-more-dangerous-than-ex-fighters>.
- Republika e Kosovës, Kryeministria. *Strategy on Prevention of Violent Extremism and Radicalisation Leading to Terrorism 2015-2020*. Prishtinë: shtator 2015. https://wb-iisg.com/wp-content/uploads/bp-attachments/6122/STRATEGY-on-PVERLT-parandalim_-_ENG.pdf.
- Reynolds, Louis, dhe Ralph Scott. *Digital Citizens: Countering Extremism Online*. Londër: Demos, 2016. <https://www.demos.co.uk/wp-content/uploads/2016/12/Digital-Citizenship-web-1.pdf>.
- "Serbia the only WB country with more trust in the government than in the EU." *European Western Balkans*, 6 gusht 2019. <https://europeanwesternbalkans.com/2019/08/06/serbia-the-only-wb-country-with-more-trust-in-the-government-than-in-the-eu/>.
- Shehaj, Albana. "After the Pandemic: Perils and Promise for Western Balkans." *Balkan Insight*, 20 prill 2020. <https://balkaninsight.com/2020/04/20/after-the-pandemic-perils-and-promise-for-western-balkans/>.

Rreth Notës

Autorë: Milo Comerford dhe Simeon Dukic

Milo Comerford është Drejtues i Lartë i Politikave dhe Kërkimeve, i cili drejton punën e Institutit për Dialog Strategjik (ISD) për zhvillimin e qasjeve kërkimore novatore dhe politikave të reagimit ndaj ekstremizmit islamik. Milo informon rregullisht vendimmarrësit e lartë anembanë botës për sfidën që paraqesin ideologjitë ekstremiste dhe këshillon qeveritë dhe agjencitë ndërkombëtare për hartimin e strategjive efektive për luftën kundër ekstremizmit. Shkrimet dhe kërkimet e tij shfaqen shpesh në mediat ndërkombëtare, duke përfshirë *The Guardian*, *CNN*, *Wall Street Journal*, *Sunday Times*, *Spectator* dhe *New Statesman*, dhe së fundi ka qenë i ftuar në transmetime të ndryshme në *BBC News*, *Sky News* dhe *Al Jazeera*.

Simeon Dukic është Drejtuesi për Ballkanin dhe Azinë Qendrore i Rrjetit të Qyteteve të Forta të ISD-së (RrQF). Puna e tij fokusohet në mbështetjen e grupeve kombëtare dhe vendore të interesit për forcimin e koordinimit dhe bashkëpunimit kombëtar-vendor në parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm. Simeon ka punuar me një sërë anëtarësh të RrQF-së në rajon për të ngritur Rrjetet Lokale shumëpalëshe dhe shumëdisiplinore të Parandalimit dhe ka ndihmuar në hartimin dhe zbatimin e Planeve Vendore të Veprimit për Parandalimin dhe Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.

Autorët shprehin mirënjohjen e tyre për Mubaraz Ahmed dhe Garentina Kraja për punimet e tyre kërkimore dhe njohuritë mbi politikën, të cilat ndihmuar në formësimin e kësaj note politike.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve. Ato nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Rrjetit "RESOLVE", Institutit të Paqes të SHBA-ve ose ndonjë organi qeveritar të SHBA-ve.

RRJETI "RESOLVE"

kërkim më i thelluar • praktikë e bazuar në informacion • politika të përmirësuar kundër ekstremizmit të dhunshëm •

www.resolvenet.org



"RESOLVE" e ka selinë në Institutin e Paqes të SHBA-ve dhe mbështetet në trashëgiminë dhjetëra vjeçare të angazhimit të thellë të Institutit në komunitetet e përfshira nga konflikti.



UNITED STATES
INSTITUTE OF PEACE
Making Peace Possible